



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 33 datë 13.9.2023**

**“PËR NJË SHTESE NË VKB NR. 71 , DATË 27.12.2022 “PËR MIRATIMIN E  
BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM  
PËRFUNDIMTAR 2023-2025 TË BASHKISË SHKODËR“TE NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të dates 13.9.2023 , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, ne mbështetje të ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar ; të ligjit nr. 84/2022 date 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023, te ndryshuar; ligji 68/2017 “Për financat e Qeverisjes Vendore” , i ndryshuar ; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar ; Udhëzimi Plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023 ” , i ndryshuar ; VKB nr. 71 , datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër“ , te ndryshuar ; Shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.15679/1, datë 06.09.2023 me objekt “Akordim fondi rezerve për njësite e veteqeverisjes vendore për vitin 2023 ” si dhe relacionit të administratës së bashkisë Shkodër,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e shtesës se planit në VKB nr. 71 , datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër“ , i ndryshuar . Kjo shtesë plani do të përfshihet në Buxhetin e Bashkisë Shkodër në **Programi 06140 “Planifikimi Urban Vendor”** ne zerin Shpenzime kapitale të patrupëzuara – Projekte ( Artikulli 230 ) në shumën 60 000 mijë në aktivitetin P06140.Q1.O1.A3: Hartimi i studimeve të fizibilitetit, planeve zhvillimore, masterplane, projekt - ide teknike dhe projekteve teknike të ndryshme të detajuara “sipas fishës bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

\_\_\_\_\_  
**Oltion LULA**



Sekretari i Këshillit bashkiak

\_\_\_\_\_  
**Denis Lesha**

Miratuar me 38 vota  
Vota Pro 0  
Vota Kunder 0  
Vota Abstenim 0  
Zbardhur me datë 15.9.2023

Hartimi i studimeve të fizibilitetit, planeve zhvillimore, masterplane, projekt - ide teknike dhe projekteve teknike të ndryshme të detajuara.

Kodi në matricë: P06140.Q1.O1.A3

#### 01. Personat e Kontaktit

<b>Emri i propozuesit të projektit</b>	Bashkia e Shkodrës	<b>Firma e propozuesit të Projektit</b>	
<b>Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit</b>	Drejtoria Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve		
<b>Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori</b>	Bashkia Shkodrës	<b>Vendodhja e Projektit</b>	Bashkia Shkodër

#### 02. Identifikimi i Idesësë Investimit

<b>Projekt Ideja</b>	Hartimi i studimeve të fizibilitetit, planeve zhvillimore, masterplane, projekt - ide teknike dhe projekteve teknike të ndryshme të detajuara.	<b>Viti 2023</b>
<b>Problemet për t'u adresuar</b>	<p>Në funksion të identifikimit dhe përgatitjes për zbatim të investimeve strategjike, të cilat do të sjellin një nxitje të zhvillimit ekonomik në nivel lokal dhe rajonal, Bashkia Shkodër në përputhje me misionin e saj përcaktuar në Ligjin Nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar , kërkon të angazhojë shërbime konsulence të cilat do të përgatisin studime fizibiliteti, plane zhvillimi e masterplane zhvillimi në nivel lokal e rajonal, projekt-ide teknike, projekte teknike të detajuara, etj në funksion të përgatitjes së projekteve të realizueshme dhe me normë kthimi ekonomik, projekte të cilat më pas do të angazhohen për zbatim në programe dhe thirrjeve të ndryshme të financimit, me buxhet shteti dhe me institucione financiare të huaja.</p> <p>Nëpërmjet këtij projekti synohet të përgatiten studime/dokumente për planifikimin e investimeve në kuadër të projekteve që financohen nga Bashkia Shkodër, Qeveria Shqiptare apo Donatorë. Përgatitja e këtyre studimeve dhe projekteve është e nevojshme për të siguruar financimin dhe shkuar drejt një maturimi të sigurt të projekteve teknike dhe e realizimit të investimeve publike të suksesshme.</p>	
<b>Emri i Programit</b>	Planifikimi Urban Vendor	
<b>Qëllimet dhe objektivat e programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen</b>	<p>Subjekti i kësaj konsulence është gjithë territori i Bashkisë Shkodër dhe do të fokusohet kryesisht në hartimin e:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Planeve të lëvizshmërisë (mobilitetit)</li> <li>• Masterplaneve dhe Planeve të Detajuar Vendor</li> </ul> <p>Studimeve fizibilitetit, projekt-ideve teknike, projekteve teknike të ndryshme të detajuara për zbatim për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Infrastrukturë rrugore dhe objekte të konektivitetit</li> <li>• Sheshe urbane, mobilimit urban dhe fasadave të ndërtesave</li> <li>• Objekte Arsimore</li> <li>• Objekte Sociale</li> <li>• Objekte Sportive</li> <li>• Objekte Kulturore</li> <li>• Objekte të Trashëgimisë Kulturore dhe Arkitektonike, muzealizimit</li> <li>• Objekte Administrative</li> <li>• Objekte në funksion të turizmit</li> <li>• Tregje dhe Merkata publike</li> <li>• Parqe, Lulishta, Peisazhe</li> <li>• Etj</li> </ul>	

## 0.3. Kostot e Projektit

ne mije leke

	Viti 2023
Kosto	60 000

## 04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i Projekt Idesë
Drejtuesi i Programit në Institucionin Buxhetor (IB)	Drejtoria Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve			
Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka)				
Sekretari i Përgjithshëm				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë
Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (nqs ka)				